



**Republika e Kosovës - Република Косово - Republic of Kosovo**

**Qeveria – Влада - Government**

*Zyra e Kryeministrit / Канцеларија премијера / Office of Prime Minister*

*Zyra për Çështje të Komuniteteve / Канцеларија за питања заједница / Office for Community Affairs*

## **DOKUMENT I PËRBASHKËT:**

# **ANGAZHIMI NË NGRITJEN E BASHKËPUNIMIT DHE KOMUNIKIMIT NË MES TË INSTITUCIONEVE TË NIVELIT QENDROR TË CILAT U SHËRBEJNË KOMUNITETEVE NË KOSOVË**

**I ZHVILLUAR NGA PËRFAQËSUESIT E  
KKK, ZÇK/ZK, MKK DHE MAPL**

**Qershor 2013**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA**

MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM / MINISTARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRATAK /  
MINISTRY OF COMMUNITIES AND RETURN



**REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT  
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO - URED PREDSEDNIKA**

KËSHILLI KONSULATIV PËR KOMUNITETE / CONSULATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES /  
KONSULTATIVNO VEĆE ZA ZAJEDNICE



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA - VLADA – GOVERNMENT**

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL / MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE  
LOKALNE SAMOUPRAVE / MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION



## **PËRMBAJTJA:**

<b>I. HYRJE .....</b>	<b>4</b>
<b>II. INSTITUCIONET QENDRORE ME PËRGJEGJËSITË KYÇE PËR KOMUNITETET E KOSOVËS: MANDATET DHE FUSHAT E AKTIVITETEVE PRIORITARE .....</b>	<b>5</b>
<b>III. DISKUTIMET NË PUNËTORINË NË MAL TË ZI: SFIDAT KYÇE DHE PRAKTIKAT E MIRA NË LIDHJE ME KOORDINIMIN INSTITUCIONAL NË NIVEL QENDROR .....</b>	<b>8</b>
<b>IV. REKOMANDIMET .....</b>	<b>10</b>

## I. HYRJE

Në vitin 2012, Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit ka zhvilluar bisedime me OSBE-në për nevojën e përmirësimit të bashkëpunimit dhe të komunikimit ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe me mekanizmat që merren me të drejtat dhe çështjet e komuniteteve. Si rezultat i këtyre bisedimeve është zhvilluar projekti, i financuar nga OSBE-ja në vitin 2013, duke përfshirë krijimin e një grupi punues të përbërë nga aktorët kyç në nivelin qendror.

Grupi punues përbëhet nga përfaqësues të katër institucioneve kyçe qeveritare, dy ministrive kyçe, dhe dy autoriteteve kyçe që merren me çështje të komuniteteve : Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) dhe Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK). Nga çdo institucion apo mekanizëm është kërkuar që t'i delegojnë nga disa përfaqësues për të punuar si pjesëmarrës aktiv në grup. Zyra për Çështje të Komuniteteve ka luajtur një rol udhëheqës në koordinimin e punës së grupit, duke e përfshirë edhe rolin e Drejtorit të ZÇK-së si kryesues të takimeve.

Qëllimi i grupit punues është ngritja e bashkëpunimit përmes diskutimeve dhe shkëmbimit të informacioneve mbi situatën aktuale në lidhje me punën e përbashkët dhe komunikimin, si dhe propozimi i mënyrave për përparim dhe përmirësim. Kjo ka përfshirë një sërë takimesh për shqyrtimin e problemeve dhe shkëmbimin e informacioneve për mandatet, fushat e punës, fushat e sakta tematike të punës së përbashkët, barrierat e përbashkëta dhe shembujt e praktikës së mirë. Punëtorja, e mbajtur në Mal të Zi në qershor të vitit 2013, ofroi mundësi për t'i shqyrtuar problemet më hollësisht, por edhe grupi ka përfituar shumë nga prania e Ministrit për Komunitete dhe Kthim. Diskutimet në këtë punëtori, dhe të gjitha kontributet e pjesëmarrësve, kanë mundësuar zhvillimin e këtij dokumenti, i cili ka për qëllim ta tregojë rrugën kah ngritja e bashkëpunimit ndër-institucional lidhur me çështjet e komuniteteve.

## II. INSTITUCIONET QENDRORE ME PËRGJEGJËSITË KYÇE PËR KOMUNITETET E KOSOVËS: MANDATET DHE FUSHAT E AKTIVITETEVE PRIORITARE

### Mandati i Zyrës për Çështje të Komuniteteve

Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) është themeluar me vendimin e Kryeministrit në vitin 2008. Mandati i zyrës është që ta koordinojë punën e organeve qeveritare, agjencive të pavarura, institucioneve të nivelit lokal si dhe të organizatave ndërkombëtare për çështjet që lidhen me komunitetet. Gjithashtu, zbatimi i politikave duke kontribuar, analizuar dhe duke ofruar këshilla në lidhje me politikën e qeverisë, dhe kur është e nevojshme, edhe informimi dhe këshillimi i Kryeministrit, vlerësimi i politikave për komunitete dhe zgjidhja e problemeve praktike të komuniteteve.

Përveç që e njofton publikun për çështjet e rëndësishme në lidhje me komunitetet, ZÇK-ja e analizon situatën, i identifikon mangësitë në zbatimin e legjisllacionit, ia rekomandon Kryeministrit marrjen e masave, i thekson objektivat për secilin nga organet qeveritare dhe e monitoron efektin e masave të cilat i ka ndërmarë secili institucion në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. ZÇK-ja e ndihmon Qeverinë në përcaktimin dhe zbatimin e politikave të duhura në një mënyrë unike dhe koherente, përmes analizës, ofrimit të këshillave dhe mbështetjes në formulimin e politikave. Gjithashtu, në mënyrë strategjike përdor mjetet e veta për t'i përmbushur nevojat e komuniteteve, punon në përmirësimin e komunikimit efikas me komunitetet, promovon trajtimin e barabartë të të gjitha komuniteteve dhe rregullisht shkëmben informacione me partnerët relevantë.

### Prioritetet e ZÇK-së për vitin 2013.

1. Bashkëpunimi me ministritë dhe institucionet në nivel qendror
2. Bashkëpunimi me komunitat
3. Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare
4. Bashkëpunimi me ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare
5. Ndihma për personat e rrezikuar në aspektin social
6. Zhvillimi ekonomik
7. Arsimimi

**Iniciativa:** Politikat e punësimit për komunitetet jo-shumicë. Ashtu si në vitin 2012, kur ZÇK ka qenë kryesuese e grupit punues për reformimin e Komisionit për Gjuhët dhe krijimin e politikave gjuhësore, ZÇK në vitin 2013 do të themelojë grupin punues që do të punojnë në përmirësimin e masave ligjore për punësimin e komuniteteve jo-shumicë.

### Mandati KKK-së

Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete është sigurimi i një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, të ndihmojë në organizimin dhe artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjisllacionin, politikat dhe programet publike strategjike të cilat kanë një rëndësi të veçantë për ta. Mandati i KKK-së është ta ofrojë një forum për konsultime dhe bashkërendim midis komuniteteve dhe të sigurohet një funksionim efikas i organizatave përfaqësuese të komuniteteve; gjithashtu t'ua ofrojë mundësinë komuniteteve pakicë që në faza të hershme, të marrin pjesë në nismat ligjore apo politike të cilat inicohen nga Qeveria ose Kuvendi, të sugjerojnë nisma të tilla dhe që mendimi i tyre të përfshihet në projekte dhe programe përkatëse, duke përfshirë edhe strategjinë dhe raportin vjetor.

**Prioritetet e KKK-s janë:**

Krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave për komunikim dhe koordinim si një domosdoshmëri për t'u siguruar nga njëra anë që interesat e të gjitha komuniteteve merren në konsideratë dhe u drejtohen palëve të interesuara, dhe në anën tjetër se këto mekanizma gjithashtu do të sigurojnë që rekomandimet e bëra nga ana e KKK-së do të zbatohen dhe do të monitorohen. KKK-ja do ta vazhdojë dhe do ta forcojë bashkëpunimin me komunitete dhe shkëmbimin e informacioneve në mes të KKK-së dhe sektorit qeveritar, organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesve të tjerë të pushtetit lokal.

Ndër të tjera KKK-ja ka edhe prioritetet në vazhdim, si: që personeli të jetë kompetent dhe i kualifikuar për çështje të caktuara të rëndësishme për zbatimin e mandatit të KKK-së, siç janë çështjet ligjore dhe ato të komunikimit. KKK-së duhet t'i ndahen mjete të mjaftueshme dhe buxhet i pavarur në mënyrë që ta zbatojë mandatin e saj. KKK-ja e përcjell zbatimin e plotë të dispozitave të Kushtetutës, ligjeve, politikave dhe strategjive që janë me interes për komunitetet nga institucionet në nivelin qendror dhe lokal, realizon vizita nëpër komuna, vizita në vendet e rajonit (shkëmbimi i përvojave me vendet e rajonit), organizimi dhe mbajtja e konferencave dhe njoftimeve të rregullta për shtyp duke përfshirë edhe organizimin e konferencave dhe njoftimeve të jashtëzakonshme për shtyp, shkëmbimi i rregullt i informatave me EULEX-in, OSBE-në, KE-në, Këshillin e Evropës dhe të tjera, KKK-ja e ka proritete edhe themelimin e bazës së të dhënave të OJQ-ve të Komuniteteve, dhe të dërgojë raporte mujore. Gjatë vitit t'i organizojë katër takime me OJQ-të dhe akterët tjerë lokal, ta mirëmbajë uebfaqen e KKK-së dhe t'i publikojë si aktivitetet e KKK-së ashtu edhe të grupit punues.

**Misioni dhe mandati i MAPL-së**

Misioni ynë është që ta avancojmë qeverisjen lokale, duke punuar së bashku me komunat përmes koordinimit, fuqizimit dhe asistencës për të siguruar shërbime të përgjegjshme dhe efektive në nivel lokal sa më afër qytetarëve.

**Mandati i ministrisë është të:**

1. Zhvillojë politika dhe ta zbatojë legjisllacionin për vetëqeverisje efektive lokale
2. Promovojë dhe t'i afirmojë të drejtat e vetëqeverisjes së organeve lokale në pajtueshmëri me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.
3. Kryejë detyra në fushën e qeverisjes lokale, siç është e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
4. Koordinohet me ministritë përkatëse për ofrimin efektiv të shërbimeve që kontrollohen nga qendra, duke përfshirë si resurset njerëzore ashtu edhe ato financiare.
5. Koordinohet me Ministrinë e Financave që të sigurohet se administrata komunale i ka mjetet e duhura financiare për kryerjen e detyrave të veta, duke i përfshirë edhe investimet publike.
6. Mbështetë dhe t'i përkrahë komunat në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel lokal,
7. Koordinojë aktivitetet me ministrit përkatëse dhe komunat me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, strategjive dhe planeve të veprimit në fushën e të drejtave të njeriut, në nivel lokal,
8. Mbikëqyrë funksionimin e komunave në bazë të legjisllacionit në fuqi.
9. Kujdeset për mbarëvajtjen e planit evropian për veprim në fushën e vetëqeverisjes lokale.



## **Prioritetet kyçe të MAPL-së**

1. Të punojë me ministritë qendrore dhe palët kyçe të interesit = në zhvillimin dhe fuqizimin e kornizës ligjore të vetëqeverisjes lokale, ashtu që të bëhet harmonizimi i rregulloreve dhe me këtë të forcohet zbatimi i ligjit në nivelin lokal dhe atë qendror;
2. Të vazhdojë me ngritjen e kapaciteteve të komunave lokale për t'u ofruar shërbime votuesve të vet në mënyrë të drejtë dhe efikase;
3. Të forcojë më tej proceset e përgjegjësive demokratike në nivel komune;
4. Ta udhëheqë dhe përkrahë zbatimin e Planit për të drejtat e njeriut në Kosovë në nivel lokal;
5. Ta zhvillojë dhe ngris kapacitetin administrativ për ta lehtësuar decentralizimin, duke pasur parasysh këndvështrimet dhe interesat e të gjitha komuniteteve në Kosovë;
6. Të bashkëpunojë me ministritë tjera në mënyrë që të zgjidhen fusha të caktuara të decentralizimit fiskal dhe administrativ;
7. Ta promovojë zhvillimin ekonomik përmes hapjes së vendeve të reja të punës, përmes menaxhimit të katastroës dhe tokës dhe promovimin e prodhimeve bujqësore si dhe punëve që lidhen me to;
8. Ta bëjë përgatitjen e planit vjetor të aktiviteteve për çdo vit të kësaj strategjie;

## **Mandati i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim :**

Ministria për Komunitete dhe Kthim është themeluar më 24 janar 2005.

1. Ministria për Komunitete dhe Kthim punon në krijimin e kushteve për kthimin e personave të zhvendosur në aspektin e sigurimit të kushteve të nevojshme për ndërtimin e njësive të banimit, krijimit të kushteve për shkollimin e të kthyerve në gjuhën amtare, sigurimit të shërbimeve shëndetësore për të kthyerit si dhe të ndihmës që të kthyerit t'i fillojnë bizneset e veta, gjë që është tejet e rëndësishme për një kthim të qëndrueshëm.
2. Ministria është duke punuar në ndërtimin e besimit dhe pajtimit në mes të komuniteteve, kështu që përmes projekteve dhe granteve të ndryshme e mbështet edhe komunitetin pritës.
3. Ministria bashkëpunon me institucionet e tjera në nivel qendror dhe komunal, që përfshin masat për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të interesave të të kthyerve, si në fushën e lirisë së lëvizjes dhe të sigurisë në përgjithësi, ashtu edhe në të drejtën e përdorimit të gjuhës, të lirisë së shprehjes, arsimimit dhe të punësimit.
4. Bën koordinimin me ministritë, me komunat dhe me insitucionet tjera, dhe e gjithë kjo me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për kthim të qëndrueshëm dhe për stabilizimin e komuniteteve.

## **Prioritet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim:**

1. Procesi i kthimit të romëve, ashkalinjve dhe të egjiptianëve nga kampet e Maqedonisë dhe të Malit të Zi
2. Përfundimi i projektit RRK III dhe përgatitja për RRK IV
3. Përfundimi i projektit CSP, stabilizimi i komuniteteve
4. Hartimi i Strategjisë së re të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim 2014- 2018
5. Finalizimi i të gjitha kërkesave të miratuara të të kthyerve dhe të komuniteteve që i kanë kaluar procedurat
6. Përfundimi i të gjitha projekteve të planifikuara infrastrukture.
7. Themelimi i grupit punues ndërministror për zgjidhjen e çështjes së kthimit
8. Themelimi i grupit punues rajonal për kthim

### **III. DISKUTIMET NË PUNËTORINË NË MAL TË ZI: SFIDAT KYÇE DHE PRAKTIKAT E MIRA NË LIDHJE ME KOORDINIMIN INSTITUCIONAL NË NIVEL QENDROR.**

#### **Sfidat kyçe**

##### ***i. Mungesa e informacioneve dhe qarkullimi i dobët i informacioneve***

- Komunikimi i brendshëm i dobët në institucione, duke përfshirë hierarkinë dhe përgjegjësitë.
- Arritja e dobët e informacioneve deri tek autoritetet tjera qeveritare dhe deri tek institucionet.
- Arritja e dobët e informacioneve deri tek publiku-mungesa e vetëdijes në mes të komuniteteve për rolet e ndryshme të institucioneve dhe për përgjegjësitë e tyre
- Niveli i ulët i vëmendjes së mediave ndaj institucioneve të ndryshme është shkaktar i problemeve për mungesën e vetëdijes tek komunitetet.
- Mungesa e shpërndarjes së dokumenteve dhe informacioneve kyçe (kontributet në dy sfidat e theksuara më sipër). Për shembull, për disa nga institucionet qendrore, mungesa e informacioneve në dispozicion të publikut për planin e punës ose për raportet vjetore të aktiviteteve të përfunduara
- Për disa institucione, komunikimi i dobët apo me vështirësi me mekanizmat komunal.

##### ***ii. Burimet (Resurset) e kufizuara***

- Mungesa e burimeve financiare për t'u plotësuar funksionet kyçe dhe përgjegjësitë e mandateve (për disa nga institucionet qendrore)
- Mungesa e personelit me kualifikime përkatëse profesionale dhe me përvojë pune në lidhje me çështjet e komuniteteve. Punësimi i kandidatëve të duhur është një sfidë, veçanërisht për ata të komuniteteve jo-shumicë siç janë komuniteti rom, ashkalinj dhe ai egjiptian sidomos në nivelin lokal.

##### ***iii. Të kuptuarit e pasaktë për rolet e institucioneve dhe pritshmëritë joadekuate***

Problemi qëndron në atë se shumë komunitete jo-shumicë e kuptojnë Ministrinë për Kthim dhe Komunitete (MKK) si dhe Zyrën për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) si institucione të vetme qendrore të cilat do t'u përgjigjen nevojave të komuniteteve jo-shumicë. Kjo mund të sjellë deri tek ajo që nga MKK-ja dhe ZÇK-ja të pritët veprimi në fushat siç janë: siguria, shëndetësia, punësimi e të ngjashme; kurse institucionet përgjegjëse për këto fusha janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe roli i tyre është që t'u shërbejnë të gjitha komuniteteve dhe komunave në Kosovë.

## **Praktikat e mira**

### ***i. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe qëllimet e përbashkëta***

Bashkëpunimi ndërinstitucional është posaçërisht i theksuar në planet vjetore dhe në dokumentet strategjike. Që të katër institucionet kanë theksuar në veçanti bashkëpunimin ndërinstitucional dhe komunikimin në nivel qendror, si dhe përmirësimin e komunikimit me autoritetet lokale si prioritet për planifikim strategjik ose për planifikim të aktiviteteve (në planet vjetore të punës ose në dokumentet strategjike të MKK-së dhe KKK-së, në draftimin e strategjisë së MAPL-së dhe në prioritetet e theksuara të MKK-së, strategjitë e të cilave janë duke u zhvilluar aktualisht).

### ***ii. Shembujt e koordinimit të mekanizmave ekzistues***

Janë theksuar disa raste ku përfaqësuesit e disa institucioneve qendrore rregullisht janë kyçur në takimet e institucioneve tjera (p.sh.ZÇK dhe MKK si anëtarë të KKK-së). Njësoj janë theksuar rastet ku përfaqësuesit e institucioneve qendrore janë përfshirë në procese të caktuara siç janë grupet e punës për zhvillimin e kornizës ligjore dhe politike për të drejtat gjuhësore.

## IV. REKOMANDIMET

### **1. Fuqizimi i komunikimit proaktiv dhe i shkëmbimit të informatave ndërmjet institucioneve të nivelit qendror**

- Shkëmbimi i dokumenteve themelore të të gjitha institucioneve: të mandateve, planeve të aktiviteteve, strategjive, organogrameve, etj.
- Shkëmbimi në kohë i të gjitha raporteve relevante, duke i përfshirë raportet vjetore për aktivitetet e përfunduara.
- Të merren pasqyrat dhe inputet nga institucionet tjera të nivelit qendror gjatë zhvillimit të dokumenteve kyçe, p.sh të legjislacionit kyç dhe të strategjive, posaçërisht për planifikimin e dokumenteve për më shumë vite.

### **2. Sigurimi i bazës së fortë të informimit publik - me qasje të gjerë për çdo institucion.**

- Të vendosen ueb faqet e qarta dhe të përditësuara në internet për të gjitha institucionet qendrore në të dyja gjuhët zyrtare. Të vendosen linqe reciproke të internetit në faqet e të katër institucioneve.
- Të zgjerohet përdorimi i mediave duke përfshirë edhe mbulime të ndryshme mediale dhe promovime për t'i ndihmuar ngritjes së vetëdijes publike, duke përfshirë edhe publikimin e buletineve (ose versioneve elektronike).
- Të hulumtohen mundësitë për "ueb portalin e komuniteteve" i cili do të mund të përfshinte linqe si bazë për të gjitha institucionet relevante dhe spektrin e gjerë potencial të informacioneve relevante për komunitete.
- Për disa institucione, të rritet numri i vizitave në terren dhe në ngjarje apo debate publike.

### **3. Të bëhet shkëmbimi i rregullt i informacioneve të nivelit teknik dhe i konsultimeve ndërmjet institucioneve në nivelin qendror**

- Të emërtohen pikat tematike të fokusuara/personat kontaktues në fushat kyçe të cilët do të takohen rregullisht, do të marrin pjesë në grupet relevante tematike punuese dhe do ta luajnë rolin si pika të denja kontakti për shkëmbimin e specializuar të informatave. Në veçanti, fushat ku disa institucione të nivelit qendror janë aktive duhet të jenë në prioritet për koordinim tematik. P.sh. diskutimet e pjesëmarrësve kanë identifikuar fushat e përbashkëta të aktiviteteve të projekteve duke përfshirë: arsimin, zhvillimin ekonomik, ndihmën sociale, legjislacionin, bashkëpunimin e shoqërisë civile dhe infrastrukturën.
- Shkëmbimi i raporteve, vlerësimi i dokumenteve tjera relevante për fushat kyçe në lidhje me komunitetet.

### **4. Të hulumtohen mundësitë për ndërtimin e kapaciteteve të shërbyesve civil qendror dhe lokal me përgjegjësi të caktuara për komunitete.**

- Të identifikohen fushat kyçe ku janë të nevojshme shkathtësi të caktuara dhe trajnime, si dhe fusha të caktuara ku shkathësitë ose shkëmbimi i njohurive në mes të institucioneve të nivelit qendror do të ishte i dobishëm (p.sh. vlerësimi i projektligjeve)
- Të shqyrtohet sigurimi i përbashkët i ndërtimit të kapaciteteve (p.sh. Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim -).

### **5. Të hulumtohen mundësitë për bashkëpunim në iniciativa të caktuara që do të ishin të interesit të përbashkët për institucionet qendrore dhe për komunitetet.**

- Për shembull iniciativa të përbashkëta për t'u krijuar baza e të dhënave të OJQ-ve të cilat i përfaqësojnë komunitetet ose problemin e komuniteteve, vlerësimet e përbashkëta në terren apo projekte të përbashkëta komunale.



[www.kryeministri-ks.net/zck](http://www.kryeministri-ks.net/zck)  
e-mail. [zck-kpz@rks-gov.net](mailto:zck-kpz@rks-gov.net)  
tel. 038/200-14-034